



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0769
Data e Vendimit: 21.08.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik Bashkim Hamidi B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Shtime., ud. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Agim Sheqiri me datën 21.08.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e Bashkim Hamidi B.I., me nr. të protokollit 2025/0769, e datës 12.08.2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Shtime.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna Shtime., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 12.08.2025, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 0769/2025 nga OE Bashkim Hamidi B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1.

Me 30.07.2025 Komuna Shtime., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë, ku sipas këtij njoftimi Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 12.08.2025.

OE Bashkim Hamidi B.I., me 11.08.2024 OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 12.08.2025 AK e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, iniciuar nga Komuna Shtime., njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 30.07.2025, Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 12.08.2025. Ndërsa me datë 11.08.2024 OE Bashkim Hamidi B.I., kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 12.08.2025 AK e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “..në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje...”. Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 12.08.2025 nga OE Bashkim Hamidi B.I., për aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, hedhet e palejuar sepse e njëjta nuk është parashtruar në pajtim me nenin 108/A të LPP-së si dhe nenin 60 par.1 të Rregullores për Prokurim Publik. Po ashtu referuar interpretimit të KRPP-së të datës 07.11.2023, 630/2023, i cili interpretim sqaron afatet ligjore për ankimim, konstatohet se kjo ankesë hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues ka parashtruar KR me datë 11.08.2025 e cila me datën 12.08.2025 AK e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim

Autoritetit kontraktues Komuna Shtime., mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i sallave sportiv të shkollave në Muzeqinë dhe Carralevë” me numër të prokurimit 617-25-6934-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Zv. Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SHTIME**
- **OE - Bashkim Hamidi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: